

Data/Date \_\_\_\_\_

I dashur prind/kujdestar,

Në sezonin e dimrit që kaloi, Nxënësit që Mësojnë Anglisht (ELL) të klasave kopsht deri në klasën e 12 të shkollës së mesme, morën pjesë në testin e gjuhës i quajtur ACCESS që administrohet për të parë aftësitë gjuhësore të nxënësve ELL. Testi ACCESS është një test i standardizuar që mat aftësitë gjuhësore të nxënësve ELL dhe që administrohet në mbarë shtetin e Pensilvanisë. Nëpërmjet konkluzioneve të nxjerra nga ky test, ne do të kemi mundësi të monitorojmë progresin vjetor për secilin nxënës ELL.

Brenda kësaj letre do të keni edhe një raport mbi rezultatet e fëmijës suaj në testin në fjalë, ACCESS. Raporti për prindin/kujdestarin ju jep një informacion për fëmijën tuaj mbi Nivelin e Aftësisë Gjuhësore të Anglishtes. Ju mund ta mbani këtë raport si dokument dhe për të patur një pasqyrë të rezultateve të fëmijës suaj në këtë test.

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me këtë test ose me informacionin e dërguar ku shpjegohet se si fëmija juaj ka dalë në këtë test, ju lutemi kontaktoni mësuesen e ESOL-it të fëmijës suaj ose drejtorin/ren e shkollës.

Sinqerisht/*Sincerely,*